



Sukseset e Qeverisjes Vendore në Shqipëri – Vizita Studimore brënda vendit

Konteksti i projektit

USAID ka mbështetur forcimin e qeverisjes vendore dhe decentralizimin në Shqipëri për rreth 10 vjet nëpërmjet projekteve të ndryshme. Kjo mbështetje së bashku me iniciativën dhe punën e veshtirë të disa bashkive ka rezultuar në sukses, disa nga bashkitë ofrojnë një model të mirë për qeverisjen vendore në aspekte të ndryshme. Bashki të tilla si Kuçova, Pogradeci dhe Kavaja kanë bërë një punë efektive për grumbullimin e opinionit qytetar dhe zbatimin e Plan Veprimit të përmiresimit të shërbimeve për të adresuar nevojat e qytetarëve të tyre.

Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit ishte të ekspozonte eksperiencat e suksesshme për 14 bashkitë pjesmarrese në këtë projekt. Bashkitë model ishin 3:

- Bazuar në anketimin qytetar të bërë në **Kuçovë**, kjo bashki u fokusua në përmiresimin e manaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe pastrimit të rrugëve. Ajo ngriti me sukses një grup pune, analizoi situatën, përcaktoi rezultatet, indikatorët dhe synimet, adoptoi një plan veprimi dhe ngriti një sistem për të monitoruar rezultatet dhe qytetarët janë shumë të kënaqur. Gjithashtu, Kuçova nëpërmjet një granti nga USAID ngriti Zyren e Pare me një Ndalesë në Shqipëri (One Stop Shop). Kjo zyrë, jo vetëm që u kursen kohë bizneseve por rrit dhe transparencën.
- **Pogradeci** ka përdorur të njëjtat hapa për t'u fokusuar në përmiresimin e hapësirave të gjelbra dhe ndriçimin publik duke pasur kështu rezultate të kënaqshme. Ajo gjithashtu ka pilotuar një sistem për të zgjidhur përgjegjësitë e bashkisë në



mirëmbajtjen e shkollave duke përfshirë qytetarët në identifikimin e problemeve prioritare dhe zgjidhjen e tyre.

- **Kavaja** është fokusuar në shërbimin e pastrimit. Duke përdorur të njëjtat hapa ka përmiresuar këtë shërbim. Duke organizuar sesione informimi në këshillin bashkiak me materialet e përshtatshme të përgatitura për anetarët e këshillit si p.sh materialet (të përgatitura nga shefi i departamentit të shërbimeve publike) që përfshijnë informacionin e perpunuar të anketimit, me grafike, për kënaqshmerinë e qytetarëve, është më e lehtë për të bindur këshillin në aprovimin e metodave të reja që aplikohen dhe për të pasur një komunikim më efektive midis administratës, këshillit bashkiak dhe qytetarëve.

Përfitimet

Udhëtimi Studimor ndihmoi për ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e ekperiencës duke përdorur eksperiencën e tre bashkive model (Kuçova, Pogradec dhe Kavajë) në menaxhimin e performancës. 14 bashkitë pilote të përfshira në këtë program ishin: B. Curri, Pukë, Kukës, Fier, Vorë, Vlorë, Berat, Peshkopi, Bulqizë, Sarandë, Gjirokastër, Përmet, Prrenjas dhe Lezhë. Pjesëmarrësit u prezantuan me arritjet e bashkisë që po vizitonin, si dhe bashkebiseduan/debatuan me përfaqësues të Bashkisë si Kryetarin, anetarë

të këshillit bashkiak, si dhe drejtorë të departamenteve të ndryshme dhe u bënë vizita në tre qytete ku u vizituan projekte të ndryshme të quajtur të suksesshme.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ World learning/USAID

KOHËZGJATIA:

Dhjetor 2005 – January 2006

PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia Kuçovë
- ✓ Bashkia Pogradec
- ✓ Bashkia Kavajë

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.